

KMDK SH.A	Dalëse <input type="checkbox"/>
	Hyrese <input type="checkbox"/>
Nr: <u>449/2018</u>	
Data: <u>25.07.18</u>	
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A Kosovo Landfill Management Company J.S.C. kompanije za Upravljanje Deponijama na Kosovu J.D.O.	

Në bazë të nenit 20, të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 130, të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikes dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, në bazë të dispozitave të Kreut II Detyrimet e Punëdhënësit të Ligjit Nr. 04/L-161, për Siguri dhe Shëndetin në Punë, në bazë të Rregullores (MPMS) Nr. 04/2014, për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në Vendin e Punës, si dhe në bazë të nenit 7, të Statutit të Kompanisë, Bordi i Drejtoreve të KMDK SH.A, miraton këtë:

RREGULLORE Nr. 14/2018 PËR SIGURI DHE SHËNDET NË PUNË NË KMDK SHA

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimet dhe përmbajtja

Neni 1

Me këtë Rregullore për Sigurinë dhe Shëndetin në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm: KMDK SHA) përshkruhen dhe përcaktohen:

- masat e mbrojtjes në punë dhe mënyra e zbatimit të tyre;
- të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e KMDK SHA;
- të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të punësuarve;
- mënyra e organizimit të punës dhe e sigurisë në punë;
- mënyrën e mbajtjes së evidencave në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, dhe
- çështje të tjera me rëndësi për sigurinë në punë.

Neni 2

Mbrojtja në punë në kuadër të KMDK SHA, organizohet dhe zbatohet përmes dispozitave të kësaj rregulloreje për mbrojtje në punë, me qëllim të eliminimit dhe zvogëlimit të rrezikut nga lëndimet dhe dëmtimet e shëndetit duke aplikuar masa sociale organizative, ergonomike, mjekësore dhe teknike, si dhe masat e tjera të nevojshme.

Zbatimi

Neni 3

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për:

- punëtorët e KMDK SHA;
- personat që mund të jenë në praktikë profesionale, apo në trajnime dhe kualifikime;
- personat të tjerë të cilët janë të angazhuar në proceset e punës ose janë të pranishëm në procesin e punës dhe mjedisin e punës.

KAPITULLI II MASAT E MBROJTJES NË PUNË

Neni 4

Gjate fazës së organizimit të punës si dhe gjatë procesit të punës KMDK SHA përmes kësaj rregulloreje ofron masat e sigurisë në punë për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e të punësuarve, duke aplikuar masa mbrojtëse konform rreziqeve dhe shkallës së rreziqeve.

Neni 5

Masat e mbrojtjes në punë janë veprime të planifikuara të sigurisë për të gjitha nivelet e punës të cilat i ndërmer KMDK SHA, me qëllim të parandalimit të lëndimeve dhe dëmtimit të shëndetit për të punësuarit e saj.

Në kuadër të masave mbrojtëse në mënyrë të veçantë përfshihen:

- vlerësimi i rrezikut në vendin e punës dhe përcaktimin e masave për zvogëlimin apo edhe eliminimin e rreziqeve duke aplikuar zgjidhje adekuate;
- përcaktimi i vendeve të punës me kondita të veçanta dhe me natyrën e punës;
- aftësimi dhe trajnimi i të punësuarve për punë të sigurt;
- kontrollet periodike, testimi i mjeteve të punës, pajisjeve mbrojtëse personale si dhe inspektimi i kushteve të punës;
- kontrollet mjekësore paraprake dhe ato periodike për të punësuarit të cilët janë të caktuar në vendet e punës me kushte të veçanta pune;
- furnizimi dhe sigurimi i mjeteve dhe i pajisjeve për mbrojtje personale në punë;
- miratimin e udhëzimeve për punë të sigurt;
- ndalimi i përdorimit të lëndëve/substancave të varësisë.

Vlerësimi i Rreziqeve

Neni 6

- 1) KMDK SHA, vlerësimin e rreziqeve për sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve do ta rregulloj me akt të veçantë, përmes të cilit do të përcaktoj llojet e rreziqeve potenciale për çdonjërin nga vendet e punës, në bazë të së cilës mëpastaj bëhet vlerësimi i rrezikut nga lëndimet për të punësuarit e Kompanisë, do të vendosë masa me qëllim të zvogëlimit minimal apo edhe eliminimin e rreziqeve potenciale për të gjitha vendet e punës.

Vende pune me kushte të veçanta pune

Neni 7

- 1) Vendet e punës me kushtet e veçanta të punës duhet të përcaktohen me Rregulloret mbi organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në KMDK SHA bazuar në metodologjinë për identifikimin e vendeve të punës me kushte të veçanta pune, të përcaktuara me dispozitat ligjore të miratuara nga ministria kompetente.
- 2) Vende pune me kushte të veçanta, janë vende pune në të cilat mund angazhohen vetëm të punësuarit të cilët krahas kushteve të përgjithshme për themelimin e mardhënies së punës, duhet të plotësojnë edhe kërkesat e veçanta sa i përket gjinisë, moshës, përgatitjes shkollore, aftësimin profesional, gjendjes shëndetësore dhe aftësitë psiko-fizike.
- 3) Para se të bëhet caktimi i të punësuarit në vendin e punës me kushte të veçanta të punës KMDK SHA obligohet që të verifikoj nëse i punësuarit plotëson kërkesat specifike të përcaktuara paragrafit 2) të këtij neni.
- 4) Nëse, i punësuarit i caktuar në vendin e punës me kushte të veçanta të punës konsideron se, nuk është i aftë apo nuk është në gjendje ta kryejë at punë, është i obliguar ta njoftoj eprorin e drejtpërdrejtë si dhe personelin e KMDK SHA si punëdhënës i tij/saj.

Aftësimi i të punësuarve për punë të sigurt

Neni 8

Të punësuarve të caktuar në vendet e punës me kushte të veçanta të punës, KMDK SHA përmes dispozitave të kësaj rregulloreje merr përsipër që t'ua mundësojë aftësimin e tyre për punë të sigurt:

- gjatë fazës së themelimit të marrëdhënies së punës,
- në rast të caktimit në ndonjë punë tjetër,

- me rastin e ndryshmin e procesit të punës apo edhe me rastin e aplikimit të teknologjive të reja ose mjete të reja të punës,
- ne rast te mungesës që zgjatë më shumë se një vit, mund të bëhet ricaktimi vendit të punës.

Neni 9

- 1) Aftësimi/trajnimi i të punësuarve për punë të sigurt bëhet përmes “Programit për aftësimin për punë të sigurtë” (në tekstin e mëtejme: Programi), i cili në mënyrë më të detajuar rregullon:
 - qëllimet/objektivat e trajnimit;
 - procedurën dhe mënyrën e kryerjes së pjesës teorike të aftësimin/trajnimit;
 - procedurën dhe mënyrën e kryerjes së pjesës praktike të aftësimin/trajnimit;
 - periudhën kohore për aftësim/trajnim, dhe
 - mënyrën e verifikimit të aftësisë për të kryer punë të sigurt.
- 2) Programi nga paragrafi 1) i këtij neni miratohet nga Kryeshefit Ekzekutiv ne KMDK SHA.

Neni 10

- 1) KMDK SHA do të bëjë aftësimin/trajnimin teorik dhe praktik për të punësuarit e saj për punë të sigurt.
- 2) Pjesa teorike e trajnimit për siguri në punë përfshinë njohjen e të punësuarit me:
 - dispozitat nga fusha e sigurimit shëndetësor, pensional dhe invalidor,
 - mënyrën e organizimit të punës dhe të sigurisë në punë,
 - rëndësinë e mbrojtjes në punë,
 - rreziqet në vendin e punës dhe masat për eliminimin e rreziqeve,
 - mënyrën e drejtë/duhur në përdorimin e mjeteve të punës, si dhe përdorimi i mjeteve dhe pajisjeve për mbrojtjen personale në punë,
 - mënyrën e dhënies së ndihmës së parë si dhe dhënien e ndihmës vetvetes,
 - procesin e shpëtimit dhe evakuimit në rast rreziku,
 - të drejtat dhe detyrimet në lidhje me mbrojtjen në punë dhe pasojat e mosrespektimit të masave të përcaktuara për mbrojtje në punë.
- 3) Pjesa praktike e trajnimit e të punësuarve përfshin trajnime praktike për përdorim të sigurt të:
 - mjeteve të punës,
 - mjeteve dhe pajisjeve mbrojtjes personale në punë,
 - substancave/materieve të rrezikshme, etj.

Neni 11

- 1) Gjatë fazës së aftësimin/trajnimit për siguri në punë KMDK SHA, do të informojë të punësuarit e saj, me të gjitha llojet e rreziqeve që lidhen me vendin e punës së caktuar dhe me masa konkrete për siguri në punë, në përputhje me dispozitat e Rregullores së veçante për vlerësimin e rrezikshmërisë.
- 2) Aftësimin/trajnimin sipas paragrafit 1, të këtij neni do ta bëjë KMDK SHA brenda orarit të punës dhe shpenzimet e aftësimin/trajnimit do të mbulohen nga KMDK SHA.
- 3) Nëse KMDK SHA përcakton që i punësuarit saj të kryej punë në dy ose më shumë vende pune, atij/asaj do t'i mundësojë aftësimin/trajnimin për siguri ne pune për secilën prej punëve.

Neni 12

- 1) Aftësimin/trajnimin i të punësuarve për siguri në punë është kompetencë dhe përgjegjësi e personit të kualifikuar për siguri në punë si dhe e organizatorit të procesit të punës, të cilët në bashkëpunim bëjnë aftësimin sipas mënyrës dhe procedurës së përcaktuar me programin e trajnimit.

- 2) Në rast se për punë të caktuara për të cilat kërkohet mbrojtje dhe siguri specifike KMDK SHA nuk ka person kompetent dhe profesional për mbajtje të trajnimit, atëherë Kompania mund të angazhojë personin juridik ose fizik i cili është i autorizuar të mbaj trajnim adekuat për fushën e caktuar.

Neni 13

Pas trajnimit për siguri dhe shëndet të punësuarit e Kompanisë i nënshtrohen verifikimit të aftësisimit mbi trajnimin e kryer.

Neni 14

- 1) Nëse i punësuar me rastin e verifikimit/testimit nuk tregon nivel të mjaftueshëm të aftësisimit, ai është i obliguar që të vazhdoj edhe më tej me trajnim deri në arritjen e nevojshme të njohurive teorike dhe praktike, të cilën mund ta dëshmoj me ri-testimin pasues pas 30 ditëve nga testimi paraprak.
- 2) Nëse edhe nga ri-testim i fundit vërtetohet se i punësuarit nuk ka marr njohuritë e mjaftueshme teorike dhe praktike lidhur me sigurinë në punë, atëherë të punësuarin në fjalë i bëhet një sistemim i ri i vendit të punës nëse, për një gjë të tillë ekzistojnë vendet të lira puna, në përputhje me ligjin e punës.

Testimet dhe kontrollet periodike

Neni 15

KMDK SHA do të kryej kontrollet periodike për të testuar:

- mjetet e punës,
- mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes personale në punë, si dhe
- kushtet/konditat e mjedisit të punës.

Neni 16

Testimet dhe kontrollet periodike i mjeteve të punës kryhet me qëllim të verifikimit se sa po ofrojnë siguri në punë zbatimi i masave të sigurisë në punë, respektivisht të verifikohen nëse:

- janë bërë udhëzimet adekuate për punë, si dhe për mënyrat e përdorimit dhe të mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- janë bërë vendosjet e mekanizmit, mjetit apo pajisjes për punë të caktuar në vendin e duhur dhe se a i përgjigjet përshkrimeve nga udhëzuesi e sidomos nga pikëpamja e hapësirës së lire për lëvizje dhe qarkullim si dhe pozicionin e operuesit, etj.
- janë bërë vendosjet e mjetit të punës sipas udhëzuesëve të prodhuesit,
- janë vendosur shenjat sipas përshkrimeve të dhëna e të cilat kanë rëndësi të veçantë për të punësuarit,
- janë të vendosura pajisjet e matjeve, mjetet e kontrollit dhe sigurisë dhe nëse është siguruar funksionaliteti i tyre,
- janë vendosur në funksion pajisjet dhe sistemet për kyçje dhe shkyçje të makinave (në qoftë se ka edhe për kyçje dhe shkyçje edhe jashtë e makinës),
- janë vendosur sistemet dhe pajisjet për sinjalizim dhe drejtim të tyre dhe nëse ato janë në përputhje me kërkesat e projektuesit, rregulloret teknike, udhëzimet e prodhuesit, si dhe me standardet dhe rregulloret për sigurinë në punë, dhe nëse ka shenja që tregojnë rolin e funksionit dhe drejtimin e lëvizjes përfshirë edhe kyçje-shkyçjen, si dhe nëse lëvizja dhe funksioni i caktuar i sistemit përputhet me sinjalistikën dhe karakterin e veprimt,
- janë të vendosura pajisjet për mbrojtjen nga dëmtimet e mekanizmave lëvizës, apo të pajisjeve për mbrojtje nga rreziqet fizike, kimike, biologjike dhe nëse është siguruar efikasiteti i funksionimit,
- janë aplikuar të pajisjet e caktuara masat për të parandaluar shfaqjen e zhurmës, dridhjes, shfaqjen e materieve të dëmshme dhe të rrezikshme siç janë, pluhuri, avulli

dhe të ngjashme, si dhe nëse në vendin e punës po krijohet një përqendrim i tyre mbi maksimalen e lejuar,

- janë evidentuar pasoja që për shkak të ndryshimeve në transport apo në operim mund të ndodhin defekte, avari apo thyerje në pajisje dhe mekanizma dhe nga të cilat mund të rrezikohet shëndeti dhe siguria e të punësuarve,
- është kah zhvillohet një proces i sigurt dhe funksional i sistemit të tërësishëm i punës i cili përdoret përherë apo kohë pas kohe,
- janë kryer instalimet elektrike në përputhje me rregullat, veçanërisht në lidhje me sigurinë efikase të mbrojtjes kundër kontaktit aksidentale (*korrektësinë e lidhjes së rrjetit, distancën e përçuesve sipas matjeve të parapara, vendosjen dhe përzgjedhjen e pajisjes së kontrollit, dhe nëse pajisja e zgjedhur posedon masat mbrojtëse ndaj ndikimeve të jashtme dhe të ngjashme*).

Neni 17

Kontrollimet periodike dhe testimet e mjeteve dhe pajisjeve mbrojtëse personale kryhen për të përcaktuar:

- nëse ato janë prodhuar në përputhje me rregulloret e sigurisë në punë;
- nëse atyre u janë bashkangjitur udhëzimet për përdorimin e tyre, metodën e testimit, si dhe mënyrën e shfrytëzimit dhe të mirëmbajtjes,
- nëse mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes personale në punë janë adekuate dhe të përshtatshme në raport me qëllimin përdorimit në mjedisin e punës;
- nëse atyre (PMP-ve) u shfaqen në mënyrë të dukshme të dhënat e nevojshme siç janë: lloji, tipi, seria, qëllimi i përdorimit, numri i fabrikës etj, dhe
- nëse ato posedojnë certifikatat e cilësinë se materialeve nga të cilat janë prodhuar.

Neni 18

1) Si rezultat i aktivitetit të zgjeruar të veprimtarisë së Kompanisë, ku përfshihen punët administrative dhe operative me implikime të faktorëve ambiental dhe inxhinierik të punësuarit e KMDK SHA mund t'u nënshtrohen rreziqeve:

1. Fizike
2. Kimike
3. Biologjike

2) Me qëllim të parandalimit të rreziqeve të përshkruara në paragrafin 1), të këtij neni, KMDK SHA do të aplikoj testimin periodik, ndërsa vlerësimin e rrezikshmërisë do ta bëjë në përputhje me Rregulloren e veçantë si akt i brendshëm i Kompanisë..

3) Kontrollit periodik të mjedisit të punës i nënshtrohen të gjitha hapësirat dhe ambientet e punës, aty ku vlerësohet se ato mund të jenë mjedise të punës me burime potenciale të rrezikshmërisë për jetën dhe shëndetin e të punësuarve të KMDK SHA, e të cilat rreziqe mund të vijnë për shkak të rrethanave specifike dhe të natyrës specifike të veprimtarisë së punës.

Neni 19

Kontrollet periodike dhe testimet kryhen në mënyrën dhe afatin e përcaktuar sipas procedurës së Rregullores për procedurën dhe afatet për kryerjen e ekzaminimeve periodike dhe testimin e mjeteve për punë, mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes personale në punë dhe kushtet e punës.

Neni 20

1) Testimet dhe kontrollet periodike kryhen nga një ekipë e brendshme e Kompanisë e cila udhëhiqet nga përgjegjësi për shëndet dhe siguri, ndërsa për ato raste ku mungojnë kapacitetet e brendshme për testim KMDK SHA, mund të angazhohet nga jashtë një person fizik ose juridik i autorizuar për kryerjen e punëve profesionale të sigurisë në punë.

- 2) Personi përgjegjës për shëndet dhe siguri, apo eksperti i autorizuar duhet të hartoj një raport mbi testimet dhe/ose kontrollimet periodike të kryera duke dhënë mendimin e tij profesional mbi shkallën e sigurisë si dhe të masave të sigurisë në punë.
- 3) Raporti nga paragrafi 2), i këtij neni duhet ti dorëzohet Kryeshefit Ekzekutiv në aftin prej 15 ditëve nga data e kryerjes së testimit, kontrollës periodike.

Kontrollet mjekësore për të punësuarit e KMDK SHA

Neni 21

- 1) Kontrollet mjekësore për të punësuarit e KMDK SHA do të kryhen për të gjitha ato pune të cilat konsiderohen si vende pune me kondita të veçanta apo me shkallë potenciale rezikshmërie, edhe atë si në vazhdim:
 - kontrollimet/ekzaminimet paraprake mjekësor para krijimit të marrëdhënies së punës;
 - kontrollimet/ekzaminimet periodike mjekësor gjatë punës;
 - kontrollimet/ekzaminimet e jashtëzakonshme mjekësor nëse punonjësi ka munguar nga puna për më shumë se një vit, dhe
 - kontrollimet/ekzaminimet mjekësor emergjente me kërkesën e të punësuarit apo me kërkesë të KMDK SHA.
- 2) Llojit, mënyrës dhe afateve për kryerjen e kontrollimeve/ekzaminimeve mjekësore nga paragrafi 1), i këtij neni KMDK SHA i referohet akteve të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale.

Mjetet dhe Pajisjet mbrojtëse personale

Neni 22

KMDK SHA, të punësuarve të saj, u ofron në shërbim dhe përdorim mjetet dhe pajisjet personale mbrojtëse në përputhje me rregulloren e veçantë për Pajisjet mbrojtëse personale, duke ndikuar në evitimin, zvogëlimin apo edhe në eliminimin e rreziqeve për jetën dhe shëndetin e punëmarrësit.

Neni 23

- 1) KMDK SHA, gjatë fazës së blerjes së mjeteve dhe pajisjeve mbrojtëse personale në punë i ofron porositësit/furnizuesit kriteret dhe specifikimet të cilat duhet të plotësohen për mjetet dhe pajisjet mbrojtëse personale konform kushteve të parapara mbi mbrojtjen dhe sigurinë në punë.
- 2) Mjetet dhe pajisjet mbrojtëse personale mund t'u ofrohen të punësuarve të KMDK SHA vetëm nëse, ato shoqërohen me dokumentacionin e përshkruar së paku në njërën nga gjuhët zyrtare, me të gjitha të dhënat teknike dhe të sigurisë për të cilat është informuar me kohë furnizuesi ose prodhuesi i tyre.

Neni 24

- 1) I Punësuarit i KMDK SHA, është i obliguar të përdorë sipas përshkrimeve dhe mënyrës së duhur mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes personale në punë, t'i ruaj dhe t'i mirëmbaj ato.
- 2) Në rast se, mjetet dhe pajisjet mbrojtëse personale, janë dëmtuar apo nëse janë humbur me qëllim dhe për fajin e tij/saj, i punësuarit është i obliguar që KMDK SHA t'ia bëjë kompensimin.

Neni 25

Mjetet/pajisjet mbrojtëse personale të cilat verifikohen si të dëmtuara duhet të tërhiqen nga përdorimi dhe të bëhet zëvendësimi me të reja, pavarësisht afatit të skadimit të tyre.



Neni 26

- 1) Mjetet/pajisjet mbrojtëse personale në punë përcaktohen me Katalogun e aprovuar sipas Rregullores së veçante dhe bëhet evidenca me listimin i tyre, si dhe veçmas për çdo pjesë organizative të Kompanisë.
- 2) Katalogu i aprovuar sipas Rregullores së veçantë referuar në paragrafin 1), të këtij neni duhet të përfshijë: emrin e vendit të punës, emrin e mjetit/pajisjes, sasinë dhe datën e skadimit për secilën mjet/pajisje.
- 3) Katalogu i aprovuar sipas Rregullores së veçantë nga paragrafi 1), i këtij neni do të jetë në Aneksin e përcaktuar me Rregulloren "Për Pajisjet mbrojtëse personale (PMP)" ndërsa evidenca mbahet nga zyrtari i logjistikes së KMDK SHA.

**Udhëzimet për siguri në punë
(udhëzime për punë sipas mënyrës së sigurt)**

Neni 27

- 1) Në rast se, procesi i punës në veprimtarinë e KMDK SHA, kërkon aftësim plotësues për të punësuarin e Kompanisë për punë të sigurt, atëherë KMDK SHA, do të informojë të punësuarin me shkrim përmes njoftimit, udhëzimeve ose instruksioneve që kërkohen në lidhje me ecurinë e procesit të punës sipas mënyrës adekuate dhe të sigurt.
- 2) Në raste të jashtëzakonshme kur, rreziku është i menjëhershëm për jetën ose shëndetin e të punësuarit, për shkak të urgjencës, njoftimet, informacione, udhëzimet ose instruksionet, mund të jepen me gojë nga çdo i punësuar i pranishme në vendin e ngjarjes.

Neni 28

- 1) KMDK SHA, merr përsipër që të njoftoj dhe ta paralajmëroj mbi rreziqet që mund të paraqiten për shëndetin e çdo personi (klient, vizitor me leje) i cili hynë apo ndodhet në hapësirat e punës ne deponi duke ia bërë të ditura masat e sigurisë që duhet të zbatohen, si dhe duke ju dhënë edhe orientimin e lëvizjes për zonat e sigurta.
- 2) KMDK SHA, do të vendosë shenjat e sigurisë në pika të dukshme me qëllim të informimit ndaj të punësuarve si dhe të sqarimit të tyre mbi rreziqet në zona të caktuara të operimeve, drejtimin dhe orientimin e lëvizjes, për lejimet e qëndrimit në zona të evidentuara me më pak rrezik si dhe mbi masat për parandalimin dhe eliminimin e rreziqeve.
- 3) KMDK SHA, përpos personave dhe të aftësuar për punë të sigurt në zona të caktuara të cilat konsiderohen si vende potenciale të lëndimit ose dëmtimit të shëndetit, nuk lejon qasje palëve të treta apo personave të paautorizuar.
- 4) Personat e aftësuar për punë të sigurt në vendet e cekura në paragrafin 3), të këtij neni, paraprakisht marrin udhëzimet e duhura për të punuar në një vend të tillë dhe njëkohësisht furnizohen me mjete dhe pajisje mbrojtëse personale adekuate për mbrojtjen në punë.

Neni 29

- 1) Rregullat themelore dhe masat e sigurisë për operimin të sigurt, përpos dispozitave të kësaj rregulloreje do të përshkruhen edhe me Udhëzuesin/Doracakun përshëndet dhe siguri në punë me qëllim të sigurimit të mbrojtjes më të madhe të mundshme të jetës dhe shëndetit të punonjësve dhe të personave të tjerë që marrin pjesë në proceset e punës, ose janë të pranishëm në procesin e punës dhe në mjedisin e punës.
- 2) Udhëzuesi i cekur në paragrafin 1), të këtij neni, do të përshkruaj me detajishtë masat e mbrojtjes në punë përfshirë procedurat, organizimin dhe dokumentimin e menaxhimit të punimeve.

Neni 30

- 1) Në sektor të caktuara organizative të punimeve apo magazinimeve të Kompanisë, janë obligative shenjat paralajmëruese të rrezikut dhe shenjat e tjera.
- 2) Shenjat paralajmëruese të rrezikut dhe shenjat e tjera do të vendosen konform Rregullores së veçantë dhe në përputhje me vlerësimet e Komisionit të emëruar për vendosje të shenjave të sigurisë.
- 3) Komisioni i emëruar nga Kryeshefi Ekzekutiv, sipas dispozitave të rregullores së veçantë “Për shenjat e sigurisë, tabelat informuese dhe shenjat apo simbolet e tjera për përdorim në KMDK SHA”, do të bëjë zgjedhjen e vendit të punës, pajisjet e punës dhe instalimet në të cilat do të vendosen, duke u kujdesur edhe për dukjen e tyre dhe mesazhit që ato përcjellin.
- 4) KMDK SHA, do të bëjë vendosjen si dhe ndërrimin e shenjave të vjetruara me qëllim të sigurisë së vendeve të punës për të punësuarit e saj.
- 5) Të punësuarit e KMDK SHA, janë të obliguar të kujdesen për shenja paralajmëruese të mirëmbajnë si dhe të veprojnë sipas porosive të tyre.

Ndalimi i përdorimit të substancave të varësisë /lëndët narkotike

Neni 31

Në ambientet e punës si dhe gjatë orarit të punës në KMDK SHA, është e ndaluar bartja dhe përdorimi i alkoolit dhe i substancave të tjera të varësisë.

Neni 32

- 1) Në rast të dyshimit se i punësuarit është nën ndikimin e alkoolit ose ndonjë substance tjetër të varësisë, si dhe bazuar në sjelljet e tij/saj i punësuarit i KMDK SHA është i obliguar t’u nënshtrohet kontrolleve/testimeve verifikuese.
- 2) Kontrolli/testimi verifikues kryhet me propozimin e organizatorit të punës ose të eprorit të drejtpërdrejtë.
- 3) Procedura e verifikimit kryhet nga Përgjegjësi për shëndet dhe siguri në punë dhe në bashkëpunim me institucionin shëndetësor kompetent, në pajtim me rregullat e sigurisë në fuqi.

Neni 33

- 1) Në rast se tek i punësuarit vërehet prania e alkoolit ose ndonjë substance tjetër varësie, edhe nëse ai refuzon t’i nënshtrohet kontrolli, nuk i lejohet pjesëmarrja në aktivitetin e punës.
- 2) Organizatori i procesit të punës është i obliguar që, të punësuarin e cekur në paragrafin 1), të këtij neni ta largoj nga vendi i punës.
- 3) Personi përgjegjës për shëndetin dhe sigurinë në punë duhet të bëjë një raport mbi verifikimin dhe kontrollin e kryer dhe të njoftoj eprorin e drejtpërdrejtë ose Kryeshefin Ekzekutiv të Kompanisë .

**KAPITULLI III
TË DREJTAT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KMDK SHA**

Neni 34

KMDK SHA është e obliguar që:

- të miratojë një akt/rregullore “Për vlerësimin e rrezikshmërisë në aktivitetet e punës në KMDK SHA”;
- të organizoj kryerjen e punëve për siguri dhe shëndet në punë;
- të përzgjedh një person profesionist në pozitën e Përgjegjësit për shëndet dhe siguri, i cili do të vë në zbatim sigurinë në punë;

- për të punësuarit e saj, të siguroj kontrollimet mjekësore paraprake, periodike dhe ato të jashtëzakonshme;
- për të punësuarit e saj t'u siguroj mjete dhe pajisje mbrojtëse personale për punë;
- të siguroj mirëmbajtjen e mjeteve të punës, dhe pajisjeve për mbrojtje personale në kushtet e duhura;
- t'u mundësoj punonjësve të punojnë në mënyrë të sigurt;
- të zbatoj vendimet e inspektoratit kompetent të punës;
- të vendosë masa për ndihmë të parë, mbrojtje nga zjarri si dhe masat e shpëtimit dhe evakuimit në rast rreziku;
- të ndaloj çdo lloj aktiviteti/punë, i cili paraqet një kërcënim të përnjëhershëm për jetën dhe shëndetin e të punësuarve;
- të paktën një herë në vit të raportoj mbi sigurinë e të punësuarve, raport i cili së bashku me Planin e biznesit do të analizohet nga menaxhmenti dhe Bordi i Drejtorëve të KMDK SHA, (nëse konsiderohet se raporti ka implikime financiare);
- në rast të kërkesës nga ana e Inspektoratit të Punës, të sigurojë një raport mbi gjendjen e sigurisë në punë dhe shëndetin e të punësuarve, si dhe zbatimin e masave nga kjo fushë;
- që menjëherë dhe jo më vonë se 24 orë të njoftoj me shkrim Inspektoratin e Punës pas ndodhjes, së ndonjë lëndimi vdekjeprurës në punë, pastaj për lëndimet kolektive apo lëndimet e rënda në punë, si dhe në rast të shfaqjes së ndonjë dukurie të rrezikshme e cila mund të atakoj sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve të KMDK SHA;
- të kryej detyra të tjera të cilat kërkohen me dispozita ligjore dhe me akte të veçanta nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Informimi i të punësuarve

Neni 35

- 1) KMDK SHA, do të informojë të punësuarit e saj për të gjitha çështjet me rëndësi që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë në punë e në veçanti për:
 - rreziqet për shëndetin dhe sigurinë në punë,
 - masat parandaluese të mbrojtjes në punë,
 - masat që kanë të bëjnë me ofrimin e ndihmës së parë, në rast të lëndimit në punë,
 - masat e mbrojtjes nga zjarri,
 - procedurat e evakuimit të punonjësve në rastet e shfaqjes së ndonjë rreziku serioz dhe të drejtpërdrejtë,
 - obligimet e personave të ngarkuar për zbatimin e masave të mbrojtjes dhe sigurisë,
 - të drejtat në fushën e mjekësisë së punës,
 - higjienën në punë dhe ergonominë si dhe rreziqet e tjera shëndetësore në punë,
 - të gjitha efekte të dëmshme në shëndetin e të punësuarve për shkak të ndotjes së ajrit, zhurmës ose kontaminimeve të tjera në vendin e punës.
- 2) Për të gjitha çështjet e cekura nga paragrafi 1), i këtij neni, KMDK SHA do të njoftoj edhe operatorët e jashtëm të cilët kryejnë punë apo shërbime ndaj KMDK SHA.

Bashkëpunimi me Sindikatën

Neni 36

- 1) KMDK SHA, në vazhdimësi do të konsultohet me të punësuarit e Kompanisë si dhe me përfaqësuesit e sindikatës duke inkurajuar pjesëmarrjen e tyre aktive në diskutimet mbi të gjitha çështjet që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen në punë, e sidomos në rastet kur ka të bëjë me:
 - ndonjë masë që mund të ketë ndikim negativ për sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve,



- vendosjen e personit profesional për kryerjen e aktiviteteve që lidhen me mbrojtjen dhe parandalimin e rreziqeve në punë,
 - përcaktimin e personelit që merret me zbatimin e masave për ofrim të ndihmës e parë, parandalimin e zjarrit dhe evakuimin e të punësuarve,
 - vlerësimin e rrezikshmërisë për sigurinë dhe shëndetin në punë si dhe për masat mbrojtëse që do të ndërmerren,
 - listimin e fatkeqësive apo të aksidenteve profesionale që mund të ndodhin në punë si dhe raportimin e atyre fatkeqësive apo aksidenteve që lidhen me punën,
 - angazhimin i personave të autorizuar për kryerjen e punëve për mbrojtje dhe siguri në punë;
 - planifikimin dhe organizimin e trajnimit për të punësuarit e Kompanisë, si dhe pjesëmarrja në verifikimin e aftësitë të tyre për punë të sigurt.
- 2) Me rastin e kontrollës mbikëqyrëse nga ana e Inspektorit të punës, KMDK SHA, nuk do të pengoj përfaqësuesin e sindikatës së punëtorëve që të paraqes nëse ka vërejtje lidhur me mbrojtjen në punë tek inspektori.

Sigurimi kolektiv

Neni 37

- 1) KMDK SHA, do të kryej pjesën e vet të obligimeve financiare për sigurimet shëndetësor për të punësuarit e saj, në përputhje me dispozitat e Ligji Nr. 04/L -249 “Për Sigurimin Shëndetësor”, ku përfshihen lëndimet në punë, sëmundjet profesionale dhe dëmtimet e tjera që lidhen me punën.
- 2) Të siguruarit, marrin pjesë në shpenzimet e kujdesit shëndetësor themelor nëpërmjet bashkë-financimit dhe premiumeve, në pajtim me ligjin.
- 3) Premiumet për sigurimin shëndetësor prej shtatë 7%, nga të ardhurat bruto ndahen në pjesë të barabarta nga e cila KMDK SHA do të ndaj 3.5%, dhe i punësuarit 3.5%.

KAPITULLI IV

DETYRAT, TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E PUNËTORËVE

Detyrat e të punësuarit

Neni 38

- 1) I punësuarit i KMDK SHA ka për detyrë që:
 - përpara se të filloj me punë të njihet me masat e sigurisë në vendin e punës për të cilën ai/ajo është caktuar, si dhe aftësohet për zbatimin e atyre masave;
 - Kompanisë t'i jap propozime, vërejtje dhe informacione për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen në punë;
 - të kryejë kontrollat dhe ekzaminimet mjekësor për të cilat udhëzohet nga KMDK SHA;
 - gjatë kohës së punës të zbatoj masat për mbrojtjen në punë, që me kujdes të përdor mjetet e punës dhe pajisjet për mbrojtje personale në punë, të bashkëpunojnë me personin përgjegjës për shëndet dhe siguri në punë, në mënyrë që të zbatojë të gjitha masat e përcaktuara për mbrojtjen në punë;
 - konform njohurive të tij/saj, me shkrim dhe/ose me gojë, ose përmes përfaqësuesit të vet, menjëherë të njoftoj KMDK SHA, në lidhje me parregullsitë eventuale, gabimet, dëmtimet, rreziqet apo indikacionet e tjera të cilat mund të rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e të punësuarve të Kompanisë.
- 2) Në rast se, KMDK SHA nuk eliminon brenda tri ditëve parregullsitë e përmendur në piken 5, paragrafit 1), të këtij neni, edhe përkundër njoftimit, ose në rast se Kompania nuk merr masat e duhura për të evituar parregullsitë, i punësuarit KMDK SHA mund të

kërkoj ndihmë nga inspektorati i punës dhe për këtë veprim të njoftojë personin përgjegjës për shëndet dhe siguri në punë.

Të drejtat e të punësuarit në KMDK SHA

Neni 39

- 1) I punësuari i KMDK SHA ka të drejtë të refuzojë punën nëse:
 - nuk ka qenë paraprakisht në dijeni për të gjitha rreziqet, respektivisht për rreziqet në punë,
 - nuk i ofrohen kontrollet dhe ekzaminimet e përcaktuara mjekësore,
 - i kanoset një rreziku i pashmangshëm për jetën dhe shëndetin, si rezultat i moszbatimit të masave të përcaktuara për mbrojtje në punë nga ana e Kompanisë për pozitën ku është caktuar, deri sa ato masa të vihen në zbatim,
 - nuk janë aplikuar masat e përcaktuara të mbrojtjes në punë që lidhen me mjetet e punës dhe si pasoj ai/ajo mund të rrezikoj drejtpërdrejtë sigurinë dhe shëndetin e tij/saj.
- 2) Në rastet kur, i punësuari i KMDK SHA refuzon të punojë, ai/ajo është i/e obliguar që me shkrim ti drejtohet eprorit të tij me arsyet e refuzimit si dhe të jap mendimin për masat e sigurisë të cilat nuk janë zbatuar edhe përkundër faktit se ato kanë qenë të përcaktuara për zbatim nga ana e Kompanisë.
- 3) Në rast se, i punësuari refuzon të punojë, ndërsa KMDK SHA konsideron se kërkesa e tij/saj nuk është e justifikuar, ai/ajo është e obliguar që menjëherë ta njoftojë inspektoratin e punës.

Përgjegjësia e të punësuarit në KMDK SHA

Neni 40

I punësuari i KMDK SHA, i cili nuk u përmbahet masave të përcaktuara të mbrojtjes në punë, ai/ajo bën shkelje të obligimeve të punës, sipas dispozitave të Ligjit për siguri dhe shëndet në punë si dhe të dispozitave të Kontratës Kolektive.

KAPITULLI V ORGANIZIMI I MBROJTJES NË PUNË

Mënyra e organizimit të mbrojtjes në punë

Neni 41

Mbrojtja në punë organizohet në mënyrë të tillë, që të ofroj mbrojtje personale dhe kolektive për të gjithë të punësuarit e KMDK SHA dhe që atyre t'u siguroj një ambient të sigurt të punës.

Neni 42

- 1) Punët, veprimet dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen në punë, kryhen nga personi përgjegjës për shëndet dhe siguri, i cili duhet të jete profesionist për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë, sipas përkrahjeve të specifikuara të detyrave të punës me, Rregulloren Nr.01/2017 "Për procedurat e punësimit, strukturën organizative, kategorizimin dhe përkrahjen e vendeve të punës në KMDK SHA".
- 2) Personi përgjegjës për shëndet dhe siguri, i cekur në paragrafin 1), të këtij neni, duhet të përmbushë kushtet dhe kriteret sipas përcaktimeve në rregulloren Nr.01/2017 dhe të dëshmoj aftësi për organizimin e mbrojtjes në punë sipas kërkesave ligjore për këtë fushë.
- 3) KMDK SHA, sipas nevojë dhe për raste të veçanta mund të angazhoj edhe nga jashtë ndonjë person të autorizuar për kryerjen e disa aktivitetëve të sigurisë dhe shëndetit në punë, për të cilat kërkohet ekspertizë më specifike.

Personi përgjegjës për shëndet dhe siguri në punë

Neni 43

- 1) Personi përgjegjës për shëndet dhe siguri në punë ka obligim të kryej detyrat e mëposhtme:
 - të këshilloj menaxhmentin e Kompanisë rreth mjeteve dhe pajisjeve për mbrojtjen personale në punë, gjatë fazës së planifikimit, përzgjedhjes dhe të kujdeset për mirëmbajtjen e tyre;
 - të këshilloj menaxhmentin e Kompanisë gjatë përgatitjes dhe rregullimit të pozitës së punës (*caktimit të vendit të punës për të punësuarit e tjerë*);
 - merr pjesë në përgatitjen e bazës profesionale për hartimin e dokumenteve juridike dhe udhëzuese (*rregulloreve dhe doracakeve*) që kanë të bëjnë me vlerësim të rrezikut/ vlerësimin e rrezikshmërisë në punë;
 - organizon kontrole paraprake dhe periodike të kushteve në mjediset e punës siç janë dëmtimet fizike, kimike dhe biologjike, për mikroklimën dhe ndriçimin;
 - organizon kontrollime periodike dhe ekzaminime/testime të mjeteve të punës për operim, mekanizma, aparateve dhe instalimeve elektrike dhe të pajisjeve e të tjera;
 - propozon masa për përmirësimin e kushteve të punës, veçanërisht për vendet e punës me shtim të rrezikut;
 - monitoron zbatimin e masave për mbrojtje në punë dhe kujdeset që mjetet e punës të mirëmbahen në gjendje të rregullt si dhe kujdeset për mjetet dhe pajisjet mbrojtëse personale;
 - merr pjesë në hartimin e udhëzimeve për punë të sigurt dhe kontrollon zbatimin e tyre;
 - përcjell gjendjen në lidhje me lëndimet në punë dhe të sëmundjeve profesionale, si dhe të sëmundjeve që lidhen me punën, merr pjesë në përcaktimin e shkaqeve të tyre dhe përgatit raporte duke sugjeruara masat për eliminimin e tyre;
 - organizon trajnimin e punëtorëve për të aftësuar për punë të sigurt,
 - propozon masën e ndalesës në punën për vendet e caktuara të punës ose të përdorimit të mjeteve të punës në rast se konstatojnë ndonjë rrezik ose kërcënim të menjëhershëm për jetën ose shëndetin e të punësuarit;
 - bashkëpunon nga afër dhe koordinohet me institucionet e autorizuar mjekësor ose mjekun e autorizuar, për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen në punë në fushën e sigurisë dhe shëndetit;
 - udhëheqë dhe mban me evidencat me të dhënat nga mbrojtja në punë;
 - kryen dhe punët e tjera në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi si dhe përshkrimeve të kësaj Rregullore.
- 2) Në rast se, KMDK SHA lejon punë të mëtejshme edhe krahas masave të marra për ndalesa të cekura në pikën 11, të paragrafit 1), i këtij neni, Përgjegjësi për Shëndetin dhe Siguri në punë, është i detyruar ta njoftoj Inspektoratin e Punës.

Neni 44

KMDK SHA do t'i mundësojë Personit përgjegjës për shëndet dhe siguri që punën e tij profesionale ta kryejë në mënyrë të pavarur dhe të ketë qasje në të gjitha të dhënat dhe informacionet që janë relevante për mbrojtjen në punë.

Bashkëpunim me operatorët dhe puna e përbashkët

Neni 45

- 1) Në rastet kur, në të njëjtën zonë/hapësirë pune, kryhen punime së bashku me ndonjë operator/punëdhënës tjetër, atëherë KMDK SHA obligohet që para fillimit të punimeve,

- të lidhë një kontratë përmes së cilës specifikohen detyrimet reciproke mbi të drejtat dhe përgjegjësitë në organizimin dhe zbatimin e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë.
- 2) Mbikëqyrja e zbatimit të detyrimeve sa i përket mbrojtjes në punë bëhet nga Përgjegjësi i për shëndet dhe siguri në punë i KMDK SHA.
 - 3) Në rast se, operatori nuk zbaton masat e mbrojtjes në punë edhe përkundër rekomandimeve të Përgjegjësit për siguri dhe shëndet, atëherë operatorit mund ti pezullohet puna dhe të njoftohet Inspektorati i punës.

KAPITULLI VI KATEGORITË E VEÇANTA TË PUNËTORËVE

Neni 46

- 1) Gratë e punësuar dhe personat me aftësi të kufizuara nuk mund të caktohen në një vend pune ku puna është e rëndë, apo aty ku mjedisi i punës mund të jetë i dëmshëm dhe e rritë rrezikun e ndikimit në shëndetin dhe jetën e tyre.
- 2) Nuk lejohet që kohëzgjatja e punës të jetë me e gjatë se sa orarit i plotë (*max. 8 orë*) për gratë shtatzëna dhe për ato që ka fëmijë nën moshën tre vjeç.
- 3) Në rastet kur, i punësuarit me shkallë të kufizuara invaliditeti e që është i aftë për punë të caktuar KMDK SHA në përputhje me Rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e vendeve do ti përcaktoj atij/asaj vend pune që do ti korrespondojnë aftësive të tij/saj sipas nivelit profesional që ka.
- 4) Përrjashtuar nga paragrafi 3), i këtij neni, kur personi i punësuar më nuk është i aftë dhe nuk mund të sistemohet në asnjë pozite pune, atëherë KMDK SHA, do t'i sigurojë atij të drejta të tjera, në përputhje me ligjin e punës.

KAPITULLI VII NDIHMA E PARË, MBROJTJA NGA ZJARRIT DHE EVAKUIMI

Ofrimi dhe dhënia i ndihmës së parë

Neni 47

- 1) KMDK SHA, do të angazhohet për organizimin dhe sigurimin e ndihmës së parë për të punësuarit e saj në rast të lëndimit në punë ose të shfaqjes së papritur të ndonjë sëmundje derisa i punësuarit është në vendin e punës, dhe për kohën derisa i/e punësuarit të dërgohet në institucionin shëndetësor duhet ti jepet ndihma e parë nga të punësuarit e tjerë.
- 2) Trajnimi i të punësuarve, dhe verifikimi i aftësimin të tyre për ofrimin dhe dhënien e ndihmës së parë kryhet në kuadër të trajnimit/aftësimin për mbrojtje punë.
- 3) Sa i përket ndihmës së parë dhe aftësimeve KMDK SHA, do të nxjerr udhëzues.

Neni 48

- 1) Bazuar në Rregulloren për vlerësimin e rrezikshmërisë, dhe veçmas pas konstatimit se në zona/hapësira të caktuar pritet rritje e nivelit të rrezikut për lëndime në punë, KMDK SHA, do të vendosë kuti të ndihmës së parë dhe do të bëjë furnizimin e rregullt me pajisje dhe materiale adekuate për dhënien e ndihmës së parë.
- 2) Kutitë e pajisjeve të cekura në paragrafin 1), të këtij neni, duhet të vendosen në një vend të dukshëm dhe të jetë e shënjuar në mënyrë të duhur.



Mbrojtja nga zjarri

Neni 49

- 1) Për realizimin e masave të mbrojtjes nga zjarri, KMDK SHA zbaton veprime parandaluese si në vazhdim:
 - vendosje të aparateve për fikjen e zjarrit dhe mirëmbajtjen e tyre në gjendje të rregullt si dhe të mjeteve tjera kundër zjarrit,
 - mirëmbajtja në gjendje të rregullt të instalimeve elektrike dhe pajisjeve të tjera në ndërtesat dhe objekte të KMDK SHA,
 - magazinimi, kujdesi dhe ruajtja e duhur e substancave të ndezshme,
 - evitimin e kontakteve përçuese elektrike të cilat mund japin shkëndija zjarri.
- 2) KMDK SHA, përmes rregullores së veçantë për mbrojtje nga zjarri, më në detaje do të përcaktoj kriteret e masave dhe do të jap udhëzimet e veprimeve të domosdoshme për mbrojtje nga zjarri.

Shpëtimi dhe evakuimi

Neni 50

- 1) Procedura për shpëtimin dhe evakuimin e punëtorëve në rast rreziku përcaktohet nga Plani i Shpëtimit dhe plani i evakuimit i miratuar nga Komiteti për emergjencë dhe monitorim.
- 2) KMDK SHA vendos kontakte dhe mirëmban raportet e bashkëpunimi me shërbimet e duhura emergjente, ndërsa në objektet e caktuara të Kompanisë përfshirë edhe ndërtesat nëpër deponi, do të vendosen numrat e telefonit të këtyre shërbimeve në vende të dukshme.

KAPITULLI VIII LËNDIMET NË PUNË

Neni 51

- 1) Lëndim në punë, do të konsiderohet lëndimi i cili i ndodhë të punësuarit nga shkaqet/rreziqet e drejtpërdrejta, e që lidhen me detyrat e punës brenda hapësirës dhe orarit të punës në KMDK SHA.
- 2) KMDK SHA, për të lënduarin e saj në vendin dhe orarin e punës do të lëshojë një dokument në formë të shkruar mbi lëndimin e tij/saj në punë.
- 3) Përmbajtja e dokumentit si dhe procedurën për lëshimin e dokumentit të cekur në paragrafin 2), të këtij neni, i përcakton Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale.

Neni 52

- 1) I Punësuarit KMDK SHA, është i obliguar që me rastin e lëndimit të njoftoj menjëherë organizatorin e punës apo eprorin e drejtpërdrejtë, por në rast se i lënduari për shkak të lëndimit të rëndë nuk është në gjendje për të raportuar lëndimin, atëherë i punësuarit tjetër i Kompanisë e i cili është dëshmitari me i afërt i ngjarjes obligohet që të njoftoj mbi lëndimin e ndodhur.
- 2) Organizatori i punës, obligohet që menjëherë me të marr informatën mbi lëndimin e ndodhur të bëjë një raport me shkrim duke marr edhe deklaratat e dëshmitarëve okularë dhe të ndërmarr veprime të tjera, që janë me rëndësi për realizimin e të drejtave me rastin e dëmtimit në punë.

KAPITULLI IX EVIDENCAT

Neni 53

- 1) KMDK SHA, do të udhëheqë me evidencat si dhe do ti ruaj ato e posaçërisht të dhënat që kanë të bëjnë me:
 - vendi i punës (pozita), sidomos për vendet e punës me rrezik të lartë ose rrezik në rritje;
 - të punësuarit e pozicionuar në vende pune të klasifikuar si vendet me rrezik të shtuar;
 - lëndimet në punë, sëmundjet që burojnë nga vendi i punës dhe sëmundjet profesionale;
 - të punësuarit e trajnuar për mbrojtje në punë dhe të aftësuar për punë të sigurt;
 - përdorimin e substancave të rrezikshme gjatë punës;
 - testimet e kryera për mjedisin e caktuar të punës;
 - kontrollat dhe testimet e kryera të mjeteve dhe pajisjeve të punës, si dhe të pajisjeve mbrojtëse personale;
 - raportimet e mbrojtjes në punë;
 - ekzaminimet paraprake dhe kontrollimet periodike mjekësore;
 - dokumentacionin teknik (*i projekteve kryesore/ makinerive të caktuara*);
 - dokumentet nga mbrojtja në punë (*atest, raport nga gjetjet profesionale, udhëzuesit për përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të punës, etj.*).
- 2) Evidencat e cekura në paragrafin 1), të këtij neni, duhet të mbahen në përputhje me format e përshkruara si dhe në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 54

- 1) Evidencat e të dhënave mbahen në libra dhe/ose në formularët kompjuterik, ku bëhet përpunimi i të dhënave në mënyrë elektronike, por që domosdo duhet të printohen në letër *hard-coppy*.
- 2) Nëse evidencat mbahen në mënyrë kompjuterike, fletët e printuara duhet të lidhen në fund të çdo viti kalendarik.
- 3) Librat e evidencave përmbajnë numrat e faqeve të regjistrimeve.
- 4) Regjistrimi në librat e cekur në paragrafin 1), të këtij neni, duhet të bëhet menjëherë pas krijimit të kushteve për regjistrim.

KAPITULLI X DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 55

- 1) Krahas kësaj rregulloreje Bordi i Drejtorëve miraton edhe pakon e rregulloreve tjera të cilat plotësojnë dispozitat e kësaj rregulloreje.
- 2) Bordi i Drejtorëve, në periudhën prej 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, miraton:
 - Udhëzuesin/doracak për shëndetin dhe sigurinë;
 - Udhëzuesin/doracak mbi fatkeqësitë natyrore;
 - Udhëzuesin/doracak mbi dhënien e ndihmës së parë;
 - Programi i trajnimit për punonjësit për punë të sigurt.


Neni 56

Për punët të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore do të vlejnjë dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 57

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Bordi i Drejtorëve dhe ditën e nënshkrimit të saj nga ana e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve në KMDK SH.A

Kryesuesi i Bordit te Drejtoreve ne KMDK SH.A
Lundrim Cāmaj



Prishtinë, më 25/07 2018